



VENDIM

Nr. 105, datë 18.08.2015

PËR

LICENSIMIN E SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2, gërma “ç”, dhe 110 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë ekelektike”, neneve 4 pika 1 gërma “f”; 5 pika 1 gërma “f”; 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.08.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licensës (neni 9 pika 4/9 gërmat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Licensimin e shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k, ne aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMET